

Bashkim Aliji, PhD¹

UDC:
340.133:[348:28

LLOJET E ABROGIMIT NË TË DREJTËN ISLAME

ТИПОВИ НА АБРОГИРАЊЕ ВО ИСЛАМСКОТО ПРАВО

TYPES OF ABROGATION IN ISLAMIC LAW

Abstract

This paper deals with the issue of abrogation (en-Nes'h), and emphasizes the importance of studying the issue of abrogation in Islamic law in general, and the types of abrogation, in particular, considering the extent of the abrogation issue in many areas and scientific discipline, as well as the fact that the abrogation issue is directly related to the provisions of the permissible (halal) and the forbidden (haram).

The following types of abrogation are defined in this paper: Abrogation of Qur'an with Qur'an, namely abrogating of Qur'an verses between them, which, the absolute majority of the scholars allow; Abrogating the Qur'an with the Sunnah (Prophetic Tradition), for which there are three attitudes among the scholars, while in this paper we select that it is permissible to abrogate the Qur'an with the Sunnah; Abrogating Sunnah (Prophetic Tradition) with the Qur'an, for which there are two opinions, and in this paper is selected the permission of this abrogation; Abrogation with Consensus-Ijma', for which the majority of scholars stance is that the Consensus-Ijma' does not abrogate or cannot be abrogated; Abrogation of Analogy-Kiyas, for which the vast majority of scholars are of the opinion that analogy cannot be neither abrogating nor abrogated after the death of the God's prophet.

In this paper are also defined the types of abrogation based on the text and the provision, which are as follows: Abrogation of the text and

¹ Doktor në fushën e studimeve evropiane për integrim, ligjërues në Universitetin e parë privat FON – Shkup.

the provision; Abrogation of textless provision; Abrogation of the text without the provision. All three are allowed according to the majority of the scholars.

Key words: Abrogation, legal provision, argumentation, Quran, Sunnah.

HYRJJE

Nes'hu-Abrogimi është një nga çështjet më polemizuese ndër dijetarët e bazave të të drejtës islame (Usuli Fikh) dhe të shkencave të Kur'anit (Ulumu-l-Kur'an), si dhe një nga çështjet komplekse në shkencat islame në përgjithësi. Kjo çështje që është diskutuar nga dijetarët klasikë islam, akoma vazhdon të jetë temë boshte e shumë mendimtarëve bashkëkohorë muslimanë, duke marrë parasysh paraqitjen e shumë çështjeve bashkëkohore, të cilat kërkojnë përgjigje nga këndvështrimi islam, në veçanti, problemet me të cilat ballafaqohen muslimanët në Perëndim, e që shumë studiues muslimanë, në Perëndim, preferojnë ma tepër t'u referohen parimeve gjenerale në të cilat udhëzojnë ajetet kur'anore, e i ikin nocionit abrogim, me qëllim që mos ngushtohet hapësira e nxjerrjes së dispozitave nga parimet e përgjithshme kur'anore.

Çështja e abrogimit-nes'hut në veçanti është trajtuar me një kujdes të madh edhe nga dijetarët bashkëkohorë muslimanë, të cilët kanë debatuar me studiues të feve dhe drejttimeve tjera për të drejtat e njeriut dhe qëndrimet diametralisht të kundërta të Islamit dhe të drejtës pozitive perëndimore, përkitazi me të drejtën penale, gjegjësisht dënimin me vdekje, si dhe formën e zbatimit të disa dënimeve, siç janë: gurëzimi, prerja e dorës, etj.

Duke marrë parasysh këto implikime të çështjes së nes'hut-abrogimit dhe gjerësinë e shtrirjes së nes'hut në shumë fusha dhe disiplina shkencore, e që reflektojnë në shumë segmente të jetës së muslimanëve edhe në këtë kohë, si dhe faktin se çështja e nes'hut lidhet drejtpërdrejtë me dispozitat e hallallit dhe haramit, mendoj se është e rëndësishme që të trajtohet çështja e nes'hut në përgjithësi dhe e llojeve të nes'hut (abrogimit) në veçanti, duke u thirrur në literaturën autoritative të dijetarëve islamë në këtë fushë.

PËRKUFIZIMI I NOCIONEVE

Para se të kalojmë në shtjellimin e llojeve të abrogimit në të drejtën islame, duhet të ndalemi në përkufizimin e termit “nes-h”(abrogim) në të drejtën islame, si dhe në përcaktimin e objektit të llojeve të abrogimit në të drejtën islame.

1. NOCIONI NES’H-ABROGIM

1.1. *Kuptimi etimologjik:*

Në aspektin etimologjik², fjala “nes’h” në gjuhën arabe ka disa kuptime: Bartje apo kopjim dhe fshirje e prishje. Në gjuhën arabe thuhet: “nesehtu-l-kitabe” që ka kuptimin “e barta apo e kopjova librin.” Po ashtu, në gjuhën arabe, thuhet: “nesehatish-shemsu edh-dhil-le” e që d.m.th. “Dielli e ka hequr-prishur hijen”; dhe “nesehat er-rihu el-ethere” e që d.m.th. “era e ka fshirë-zhdukur gjurmën.”

1.2. *Përkufizimi terminologjik:*

Në aspektin terminologjik, për nocionin “en-nes’h” janë dhënë definicione të ndryshme, që nëse i përmendim të gjitha, do të na zinte një hapësirë relativisht të madhe të këtij punimi. Mirëpo, duke u nisur nga parimi se në terme, nuk duhet treguar shumë të ngurtë, ne do të përmendim vetëm një nga këto definicione për të kuptuar se për çka është fjala me këtë term.

Një nga përkufizimet e nocionit “en-nes’h” është edhe përkufizimi vijues: Pezullimi i një dispozite fetare të vërtetuar me një argument të mëhershëm, me një dispozitë tjetër fetare të mëvonshme.³

Kështu, shembull për këtë mund të përmendet pezullimi i kthimit në namaz kah Mesxhidi Aksaja në Kuds-Jerusalem, me dispozitën e obligimit të kthimit në namaz kah Qabeja në Mekë.

2. TOGFJALËSHI: “LLOJET E NES’HUT (ABROGIMIT)”

Togfjalëshi: “Llojet e nes’hut“ (Llojet e abrogimit), nënkupton më tepër gjëra, gjegjësisht ka disa lloje të abrogimit, varësisht se për cilin segment të abrogimit bëhet fjalë. Së këndejmi, është e nevojshme

² Shih Ibn Mendhur, *Lisanu-l-a’reb*, vëll.III, f.61 dhe *El-Mu’xhemu-l-vesit*, vëll.II, f.917.

³ Ibn Kudame, *Reudatu en-nadhir*, vëll.II, f.128.

që në fillim të sqarojmë se çka nënkuptojmë me togfjalëshin “Llojet e abrogimit.”

Në këtë pjesë diskutohet rreth abrogimit të argumenteve të së drejtës islame, gjegjësisht cili nga argumentet e sheriatit mund ta abrogojë tjetrin apo thënë ndryshe a mund të abrogohet Kur’ani me Kur’an, Suneti me Sunet dhe me Kur’an, etj.

Çështja e nes’hut është diskutuar si në nivel ndërfaqet, po ashtu edhe në nivel brendafetar. Në fakt, ne me këtë rast, nuk e kemi për qëllim që ta trajtojmë problemin e nes’hut në raport me fetë tjera, gjegjësisht nuk synojmë të debatojmë për atë se cili është qëndrimi i pjesëtarëve të feve tjera përkitazi me nes’hun, por ne këtu do ta trajtojmë qëndrimin e dijetarëve islamë përkitazi me nes’hun.

PJESËT PËRBËRËSE TË ABROGIMIT

Nga definicioni i abrogimit, kuptohet se abrogimi përbëhet nga katër elemente: mekanizmi i abrogimit-nes’hut (edatu en-nes’h); abroguesi (en-nasih); lënda e abroguar (el-mensuh); dhe subjekti të cilit i referohet abrogimi (el-mensuh anhu).⁴

Mekanizmi i abrogimit është fjala me të cilën pezullohet dispozita e miratuar më parë. Abrogues është Allahu i Madhërishtëm, i Cili i pezullon dispozitat sipas vullnetit të Tij. Vetëm nga Allahu i Madhërishtëm vijnë urdhrat për abrogimin e dispozitave.

Me këtë rast, duhet ditur se i Dërguari i Allahut, paqja e Zotit qoftë mbi të, nuk është ai që i abrogon dispozitat, por në rast se ndonjë veprim i të Dërguarit të Allahut, paqja e Zotit qoftë mbi të, flet për abrogim, në fakt është argument njoftues që flet se ekziston argument nga Allahu i Madhërishtëm se dispozita është pezulluar.⁵ Lënda e abroguar është dispozita e pezulluar. Subjekti të cilit i referohet abrogimit është personi i ngarkuar me dispozitën fetare.

1. LLOJET E ABROGIMIT NGA ASPEKTI I ARGUMENTEVE TË BURIMEVE SË TË DREJTËS ISLAME

1.1. Abrogimi i Kur’anit me Kur’an

Sa i përket abrogimit të ajeteve të Kur’anit mes vete, shumica absolute e dijetarëve e lejojnë një gjë të tillë dhe theksojnë se kjo ka

⁴ Ebu Hamid el-Gazali, *El-Mustesfa min i’lmi-l-usul*, vëll.II, f.88.

⁵ Vehbe Ez-Zuhajli, *Usulu-l-fikhi-l-islami*, vëll.II, f.934.

ndodhur në Kur'an. Në këtë ka kundërshtuar vetëm Ebu Muslim El-Esfahani.

Këtë qëndrim, shumica e dijetarëve e kanë argumentuar si vijon:

a) Një gjë e tillë është e lejuar, ngase bëhet fjalë për dy tekste të të njëjtit rang në autenticitet, për atë, nuk është larg mendjes që ta derogojnë njëri-tjetrin.

b) Abrogimi i këtillë ka ndodhur në Kur'an, dhe vetë ndodhia është argument që e vërteton këtë dukuri. Në këtë drejtim flasin disa ajete kur'anore, e këtu, sa për ilustrim do ta përmendim ajetin: **“O Pejgamber! Nxiti besimtarët për luftë. Nëse prej jush janë njëzet të durueshëm, (trima të fuqishëm), do t'i mundni dyqind, e nëse janë njëqind, do t'i mundni njëmijë sish që nuk besuan, për shkak se ata janë njerëz që nuk kuptojnë (pse luftojnë).”**⁶ Sipas këtij ajeti, në luftë çdo njëri do të luftojë me dhjetë veta. Dispozita e këtij ajeti u derogua me dispozitën lehtësuese të ajetit vijues: **“Allahu ju bëri lehtësim tash duke ditur se jeni dobësuar. Nëse prej jush janë njëqind të durueshëm, do ti mundni dyqind, e nëse prej jush janë njëmijë, me ndihmën e Zotit do t'i mundni dy mijë. Allahu është me ata që janë të durueshëm.”**⁷

Kur bëhet fjalë për abrogimin e ajeteve kur'anore, duhet nënvizuar dy çështje me rëndësi:

- Nuk lejohet abrogimi i gjithë Kur'anit, ngase ai është mrekulli që ka vlerë të përhershme. Po ashtu, ky sheriat-legjislatura islame, është i fundit, dhe si i tillë, nuk mund të abrogohet në tërësi, e të mbeten njerëzit pa sheriat.⁸

- Nuk duhet nxituar në klasifikimin e një dispozite, të abroguar, por fillimisht, duhet munduar për të bërë harmonizimin e dispozitave, që në shikim të parë, duken kontradiktore.

1.2. Abrogimi i Kur'anit me Sunet (Traditën Profetike)

Përkitazi me këtë çështje, ka tre qëndrime:

I-Lejohet abrogimi i ajeteve kur'anore me hadithe, me kusht që hadithi të jetë i gradës “mutevatir” dhe “mustefid”. Ky është qëndrim i shumicës së dijetarëve.⁹

⁶ El-Enfal: 65.

⁷ El-Enfal: 66.

⁸ Vehbe Ez-Zuhajli, *Usulu-l-fikhi-l-islami*, vëll.II, f.963.

⁹ Muhamed Ebu Zehre, *Usulu-l-fikh*, f.183.

Argumentimi: Nuk ka pengesë të ndodh diçka e tillë ngase edhe Kur’ani edhe Suneti-Tradita profetike, që të dy janë prej Allahut të Madhërishëm.¹⁰ Në fakt, edhe thëniet dhe veprimet e të Dërguarit të Allahut, me karakter fetar, janë të frymëzuara nga Allahu, gjegjësisht profeti nuk ka thënë asgjë, në çështjet fetare, nga mendja e vet, por vetëm atë që ia ka shpallur Allahu i Madhërishëm. Në këtë drejtim flet edhe hadithi: “Vërtet, mua më është dhënë Kur’ani dhe diçka e ngjashme si ai, bashkë me të”.¹¹

Po ashtu, ata janë thirrur edhe në ndodhjen e derogimit të ajeteve të Kur’anit me hadithe. Shembull për këtë e përmendin abrogimin e dispozitës së ajetit: **“Kur ndonjërit prej jush i është afruar vdekja, nëse lë pasuri pas vete, testamenti (vasijeti) për prindërit dhe për të afërmit u është bërë juve obligim, por ashtu siç është drejtë. Për ata që janë të devotshëm kjo është detyrë që lypet kryer”**¹², me hadithin: **“Allahu ia ka dhënë çdo njërit pjesën që i takon, për atë, nuk ka testament për trashëgimtarin”**.¹³

Mirëpo, ndaj këtij argumenti është replikuar me atë se, dispozita e këtij ajeti, nuk është abroguar me hadith, por me ajetet e trashëgimisë. Në këtë drejtim, Ibn Kethiri ka komentuar: “Ky ajet përmban urdhrin për t’u lënë testament prindërve dhe të afërmeve, gjë që sipas mendimit më të saktë, ka qenë obligim para zbritjes së ajetit të trashëgimisë. Me zbritjen e ajetit të pjesëve të trashëgimisë-feraid, ky ajet derogohet dhe, trashëgimia e përcaktuar, bëhet obligim nga Allahu. Hisen e trashëgimisë, trashëgimtarët e marrin detyrimisht, pa testament dhe pa u varur nga dëshira e pronarit të atij që e le testamentin. Ibën Ebu Hatimi transmeton prej Ibën Abasit, i cili në lidhje me fjalët e të Lartëmadhërishmit: **“... testamenti (vasijeti) për prindërit dhe për të afërmit...”**, thotë: “Këto fjalë të Lartëmadhërishmit janë deroguar nga ajeti vijues: **“Meshkujve u takon pjesë nga pasuria që e lënë prindërit e të afërmit (pas vdekjes), edhe femrave u takon pjesë nga ajo që lënë prindërit e të afërmit, le të jetë pak ose shumë ajo që lënë, u takon pjesë e caktuar (nga Zoti).”**¹⁴ Pastaj, Ibën Ebu Hatim thotë: “Transmetohet prej Ibën Omerit, Ebu Musës, Sei’d ibën El-Musejjibit, El-Hasenit, Muxhahidit,

¹⁰ El-Gazali, *El-Mustesfa*, vëll.II, f.99.

¹¹ Hadithin e ka transmetuar Ebu Davudi. Shih: *Aunu-l-ma’bud sherhu Suneni Ebi Davud*, vëll.XII, f.231. Hadithi nr.4591.

¹² El-Bekare: 180.

¹³ Hadithin e ka transmetuar Tirmidhiju dhe ka thënë: “Hadithi është i mirë autentik-hasenun sahih”. Shih: *Tuhfetu-l-ehvedhij*, vëll.VI, f.314; po ashtu e ka transmetuar edhe Nesajju, shih: *Sunen En-Nesai me’a hashijetis-sujuti*, vëll.VI, f.247.

¹⁴ En-Nisaë: 7.

Ataut, Sei'd ibën Xhubejrit, Muhammed ibën Sirinit, I'krimes, Zejd ibën Eslemit, Er-Rebi'ë ibën Enesit, Katades, Es-Suddijut, Mukatil ibën Hajjanit, Tavusit, Ibrahim En-Nehajut, Shurejhrit, Ed-Dahakut dhe Ez-Zuhrijut se ky ajet është i deroguar me ajetin e trashëgimisë.”¹⁵

II-Lejohet abrogimi i ajeteve të Kur'anit me hadith, edhe nëse nuk është i gradës “mutevatir”, gjegjësisht lejohet të abrogohet edhe me hadith të gradës “ahad”. Ky është mendimi i Ibn Hazmit. Sipas tij, i gjithë Suneti është argument i prerë, për atë edhe lejohet ta abrogon ajetin.¹⁶

III-Ajetet e Kur'anit mund të abrogohen vetëm me ajete, por jo edhe me hadithe, pa marrë parasysh a është hadithi “mutevatir” apo “mustefid”. Ky është qëndrimi i imam Shafiut.¹⁷

Argumentimi: Në mes tjerash, imam Shafiut është bazuar edhe në ajetet vijuese:

▪ **“Ne nuk abrogojmë (pezullojmë) asnjë nga argumentet tona, apo ta hedhim në harresë e të mos sjellim edhe më të dobishëm se ai, ose të ngjashëm me të. A nuk e ke ditur se Allahu është i plotfuqishëm për çdo send?”**¹⁸ Sipas komentit të tij, ajeti në fjalë, qartë tregon se ajetet mund të derogohen vetëm me ajete të njëjta apo më të mira se ato, e Suneti nuk është i këtij karakteri.

Mirëpo, këtij argumentimi, dijetarët i janë përgjigjur si vijon:

- Edhe Suneti është te Allahu si Kur'ani në kuptim të shpalljes nga Ai. Dallimi është se Kur'ani është muxhize-mrekulli, e Suneti jo dhe leximi i Kur'anit është adhurim, e i Sunetit jo.¹⁹

- Çështja e të qenit i njëjtë dhe më i mirë, ka të bëjë me dispozitën në raport me interesin e njerëzve, e nuk ka të bëjë me tekstin.

▪ **“(i patëm dërguar) Me argumente e me libra të shenjtë. Ty ta zbritëm Kur'anin që t'u shpjegosh njerëzve atë që u është shpallur atyre, me shpresë se do ta studiojnë (Kur'anin)”**.²⁰ Ky ajet tregon se Suneti është sqarues i Kur'anit e jo abroguet i tij.

Këtij argumentimi, dijetarët i janë përgjigjur me atë se edhe abrogimi është një lloj sqarimi, gjegjësisht sqarim i përfundimit të

¹⁵ Tefsiru-l-Kur'ani-l-adhim, vëll.I, f.217.

¹⁶ Muhamed Ebu Zehre, Usulu-l-fikh, f.183.

¹⁷ El-Gazali, El-Mustesfa, vëll.II, f.101.

¹⁸ El-Bekare: 106.

¹⁹ Ez-Zuhajli, Usulu-l-fikh el-islami, vëll.II, f.972.

²⁰ En-Nahël: 44.

dispozitës së shariatit me një mënyrë fetare më të vonshme. Nisur nga ky këndvështrim, atëherë, pasi Suneti është sqarues i Kur'anit, nuk ka pengesë që të jetë edhe abrogues i tij.²¹

PËRZGJEDHJE

Pas prezantimit të mendimeve dhe argumenteve, mund të konkludojmë se lejohet abrogimi i Kur'anit me Sunet dhe është i mundshëm, edhe pse dijetarët përmendin se diçka e tillë, edhe përsëri asaj se nuk është absurde, realisht nuk ka ndodhur. Kjo, ngase edhe Suneti është shpallje e Allahut e shprehur përmes gjuhës së Muhamedit, paqja e Zotit qoftë mbi të, sikur që Kur'ani është shpallje e Allahut që i është dërguar Muhamedit, paqja e Zotit qoftë mbi të, përmes melekut të shpalljes, Xhibrilit.

Në këtë drejtim, Dr.Vehbe Zuhajli ka thënë: “Më i drejtë është mendimi i shumicës së dijetarëve, ngase edhe Suneti është prej Allahut të Madhërishëm, ashtu siç është edhe Kur'ani legjislativ prej Allahut të Madhërishëm.”²²

1.3. Abrogimi i Sunetit me Kur'an

Edhe për këtë çështje ka dy mendime, si në çështjen e mëparshme:

I-Shumica e dijetarëve janë të mendimit se lejohet abrogimi i Sunetit me Kur'an. Konstatimin e tyre e kanë bazuar në atë se, diçka e këtillë, ka ndodhur. Kështu, ajeti: “*Ne shumë herë po shohim kthimin e fytyrës tënde kah qielli, e Ne gjithqysh do të drejtojmë ty në drejtim të një kibleje (Qabja) që ti e do atë. Pra kthehu anës së xhamisë së shenjtë (Qabes), dhe kudo që të jeni (o besimtarë) kthehuni kah ajo anë. E atyre që u është dhuruar libri, ata e dinë sigurisht se kjo (kthesë) është e vërtetë nga Zoti i tyre. E Allahut nuk mund t'i fshihet ajo që veprojnë ata*”²³, e ka abroguar kthimin kah Bejtu-l-Makdisi në Kuds (Jerusalem), që ka qenë i miratuar sipas Sunetit.²⁴

II-Sipas imam Shafiut, nuk lejohet abrogimi i Sunetit me Kur'an. Sipas tij, Suneti është definuar si sqarues i Kur'anit, ndërkaq abrogimi i tij me Kur'an, e nxjerr nga ky funksion.

²¹ Ez-Zuhajli, *Usulu-l-fikhi-l-islami*, vëll.II, f.972.

²² Ibidem, 973.

²³ El-Bekare: 144.

²⁴ Ez-Zuhajli, Ibidem, 969.

Edhe në këtë rast, mendim më i drejtë është ai i shumicës së dijetarëve, por edhe mendimi i imam Shafiut, nëse analizohet mirë, nuk është në kolizion real me mendimin e shumicës së dijetarëve. Këtë e ka sqaruar dijetari i shquar Muhamed Ebu Zehre, duke thënë: “Nëse analizohet mirë, do të shihet se edhe mendimi i Shafiut është i afërt. Kjo, ngase Kur’ani nëse e abrogon një dispozitë të Sunetit, këtë patjetër ta proklamojë i Dërguari i Allahut, paqja e Zotit qoftë mbi të, me një dispozitë të re, ashtu që ajo vepër do të jetë konfirmuese e abrogimit”.²⁵

1.4. Abrogimi me Konsensus-Ixhma

Qëndrim i shumicës së dijetarëve është se Ixhmaja-Konsensusi, nuk abrogon dhe nuk abrogohet, ngase pas ndërprerjes së shpalljes, nuk ka abrogim. Ndërkaq, ajo që është abroguar me konsensus, konsensusi dëshmon për derogues që ka qenë më parë, në kohën e zbritjes së shpalljes, qoftë nga Kur’ani apo Suneti.²⁶

Disa dijetarë e kanë lejuar abrogimin e konsensusit me konsensus tjetër të njëjtë si ai. Arsyetimi i tyre është se, konsensusi, është argument i prerë, për këtë edhe nuk është gabim.²⁷

Nga ana tjetër, juristët e shkollës Dhahirite (literariste), disa juristë hanefit, disa hanbelit, disa mu’tezilit dhe Isa ibn Eban, mbajnë qëndrimin se lejohet abrogimi me konsensus, mirëpo jo me vetë konsensusin, por me mbështetjen e konsensusit në tekste.²⁸

1.5. Abrogimi i Analogjisë-Kijasit

Pjesa më e madhe e dijetarëve janë të mendimit se analogjia nuk mund të jetë, as abroguet dhe as e abroguar, pas vdekjes së të Dërguarit të Allahut. Sipas tyre, analogjia mund të jetë, abroguet dhe e abroguar, vetëm gjatë jetës së të Dërguarit të Allahut, paqja e Zotit qoftë mbi të.²⁹

Këtë qëndrim e kanë arsyetuar me atë se analogjia, nuk është argument kundër një muxhtehidi-eksperti juridik tjetër, por është argument, vetëm për atë muxhtehid i cili ka arritur në këtë analogji me mendimin dhe analizën e tij shkencore.³⁰

²⁵ *Usulu-l-fikh*, f.185.

²⁶ El-Gazali, *El-Mustesfa*, vëll.II, f.105.

²⁷ Ez-Zuhajli, *Usulu-l-fikhi-l-islami*, vëll.II, f.974.

²⁸ *Ibidem*, 975.

²⁹ El-Gazali, *Ibidem*, 109.

³⁰ Ez-Zuhajli, *Ibidem*, 976.

2. ABROGIMI NGA ASPEKTI I TEKSTIT DHE DISPOZITËS

Duke marrë parasysh tekstin dhe dispozitën, kemi disa mënyra të abrogimit:

2.1. *Abrogimi i tekstit dhe dispozitës*

Lejohet abrogimi i tekstit dhe dispozitës, sipas shumicës së dijetarëve. Në këtë drejtim kanë kundërshtuar vetëm një pjesë e mu'tezilëve, të cilët, megjithatë, nuk merren parasysh.³¹

Këtë qëndrim ata e kanë argumentuar me atë se, diçka e tillë, nuk është absurde nga aspekti logjik, e po ashtu diçka e tillë ka ndodhur. Këtë do ta ilustrojmë me thënien e Aishes: “Prej asaj që u shpall prej Kur’anit ishte edhe ajo se dhjetë të thithura të njohura në gji, e ndalojnë martesën (me fëmijët e asaj gruaje e cila i ka dhënë dikujt gji). Pastaj, ky numër u abrogua me pesë të thithura të njohura. Vdiq i Dërguari i Allahut, paqja e Zotit qoftë mbi të, e këto ishin pjesë e asaj që lexohej prej Kur’anit”.³² Bejhëkiju ka thënë: “Dhjetë të thithura, janë abroguar edhe si tekst edhe si dispozitë; ndërkaq pesë të thithura, janë abroguar si tekst, por jo edhe si dispozitë. Argument për këtë është ajo se sahabët kur e kanë tubuar Kur’anin, këtë tekst nuk e kanë regjistruar, ndërkaq kjo dispozitë ka qenë valide tek ata.”³³

2.2. *Abrogimi i dispozitës pa tekst*

Sipas qëndrimit të pjesës më të madhe të dijetarëve, lejohet abrogimi i dispozitës dhe mbetja e tekstit. Në këtë kanë kundërshtuar vetëm një pjesë e vogël e mu'tezilëve.³⁴ Këtë mund ta ilustrojmë me derogimin e dispozitës së ajetit: “*Kur ndonjërit prej jush i është afruar vdekja, nëse lë pasuri pas vete, testamenti (vasijeti) për prindërit dhe për të afërmit u është bërë juve obligim, por ashtu siç është drejtë. Për ata që janë të devotshëm kjo është detyrë që lypet kryer.*”³⁵

³¹ El-Gazali, Ibidem, 95.

³² Hadithin e ka transmetuar Muslimi. Shih: Sahihu Muslim bi sherhi En-Nevevij, vëll.X, f.26, hadithi nr.1452.

³³ Cituar sipas: Ez-Zuhajli, Ibidem, 979.

³⁴ Esh-Shenkiti, *Mudhekkiretu usuli-l-fikh*, f.71.

³⁵ El-Bekare:180.

2.3. Abrogimi i tekstit pa dispozitën

Edhe këtë mënyrë të abrogimit, pjesa më e madhe e dijetarëve, e lejojnë. Kanë kundërshtuar vetëm një pjesë e vogël dhe e pa rëndësishme e mu'tezilëve.³⁶ Këtë mund ta ilustrojmë me ajetin e gurëzimit të plakut dhe plakës, në rast se bëjnë prostitucion, i cili është abroguar si tekst, por dispozita e tij, është ende në fuqi në të drejtën islame.³⁷

PËRMBYLLJE

Nga ajo që prezantuam në këtë punim, arrijmë në disa përfundime, ndër të cilat do të veçonim:

- Abrogimi është pezullim i një dispozite, dhe ky është realitet në burimet e të drejtës islame.

- Abrogimi nuk është absurd, shikuar logjikisht, ngase Ai që e shpall një dispozitë, ka të drejtë të plotë që ta pezullojë atë dispozitë dhe ta zëvendësojë me një dispozitë tjetër.

- Abrogimi është një çështje mjaft e gjerë dhe ka shtrirje në shumë fusha dhe disiplina shkencore, e që reflektojnë në shumë segmente të jetës së muslimanëve, edhe në këtë kohë.

- Nes'hu-Abrogimi lidhet drejtpërdrejt me dispozitat e të lejuarës (hallallit) dhe të ndaluarës (haramit) në të drejtën islame dhe kjo e thekson rëndësinë e trajtimit të çështjes së abrogimit në përgjithësi, dhe llojeve të abrogimit në veçanti.

- Lejohet abrogimi i Kur'anit me Kur'an, i ajeteve kur'anore me Sunet autentik, edhe pse ka polemika për atë se cilës gradë duhet t'i takojë hadithi. Megjithatë, Suneti autentik e abrogon dispozitën e ajetit kur'anor, marrë parasysh se edhe Suneti është shpallje nga Allahu, e nuk është diçka që i dërguari i Allahut e ka thënë nga mendja.

- Mund të ndodh abrogimi i tekstit dhe dispozitës; i tekstit pa dispozitën; dhe i dispozitës pa tekstin. Për të gjitha këto, ka shembuj në Kur'anin famëlartë.

³⁶ El-Gazali, *El-Mustesfa*, vëll.II, f.97.

³⁷ Ibidem.

CONCLUSION

From what we have presented in this paper, we come to some conclusions, among which we would point out:

- Abrogation is the suspension of a provision, and this is a reality in the sources of Islamic law.

- Abrogation is not an absurd, if logically observed, since he who proclaims a provision has the full right to suspend that provision and replace it with another provision.

- Abrogation is a wide-ranging issue and has a range of areas and scientific disciplines that reflect in many segments of Muslim life even at this time.

- Nes'hu-Abrogation is directly related to the provisions of the permissible (halal) and the prohibited (haram) in Islamic law, and it emphasizes the importance of addressing the issue of abrogation in general and the types of abrogation in particular.

- It is permissible to abrogate the Qur'an with the Qur'an, the Qur'anic verses with authentic Sunnah, although there is controversy as of which degree should the prophet's saying be. However, authentic prophetic tradition abrogates the provision of the Qur'anic verse, given that even prophetic tradition is a revelation from God, and is not something that the prophet has said from his own opinion.

- The text and the provision may be abrogated; of the text without the provision and the provision without the text. For all these there are examples in the Holy Quran.

Recensentë:

Prof. dr. Nazmi Maliqi

Prof. dr. Afrim Osmani

LITERATURA

El-Gazali, Ebu Hamid Muhamed bin Muhamed. El-Mustesfa min i'lmil-usul. Redaktor: Dr.Hamza bin Zuhejr Hafidh. El-Medinetu-l-munevere.

El-Kurtubij, Muhamed ibn Ahmed. 1993. El-Xhami' li ahkami-l-Kur'an. Bejrut: Daru-l-kutubi-l-i'lmijje.

Esh-Shenkiti, Muhamed El-Emin bin El-Muhtar. (Pa vit botimi). Mudhekiretu Usuli-l-Fikhi a'la reudati en-nadhir. Bejrut: Daru-l-kalem.

Ebu Zehre, Muhamed. Pa vit botimi. Usulu-l-fikh. Kajro: Daru-l-fikri-l-a'rebij.

Ez-Zuhajli, Vehbe. 1986. Usulu-l-fikhi-l-islami. Damask: Daru-l-fikër.

Ibn El-Xheuzij. 1985. Nevasihu-l-Kur'an. Botimi i parë. Bejrut: Daru-l-kutubi-l-i'lmijje.

Ibn Ebi Talibi, Mekij. 1986. El-Idah li nasihi-l-Kur'ani ve mensuhihi. Redaktuar nga Ahmed Hasen Ferhat. Botimi i parë. Xhide: Daru-l-menare.

El-Eshkar, Omer Sulejman Abdullah. 1997. Mesail min fikhi-l-kitabi ve es-sunne. Botimi i dytë. Aman: Daru en-nefais.

Ibn Kethir, Ebu-l-Fida Ismail. 1987. Tefsiru-l-Kur'ani-l-adhim. Botimi i dytë. Bejrut: Daru-l-kutubi-l-i'lmijje.

En-Nevevij, Jahja ibn Sheref. 1995. Sahihu Muslim bi sherhi En-Nevevij. Botimi i dytë. Bejrut: Daru-l-kutubi-l-i'lmijje.

Abadi, Shemsu-l-Hak El-Adhim. 1995. Aunu-l-ma'bud sherhu Sunen Ebi Davud. Botimi i dytë. Bejrut: Daru-l-kutubi-l-i'lmijje.

El-Mubarekfuri, Muhamed ibn Abdurrahman. 1387h. Tuhfetu-l-ehvedhij sherhu Sunen Et-Tirmidhij. Medine: El-Mektebetu es-selefijje.

En-Nesaij, Ahmed ibn Ali ibn Shuajb. 1383h. Sunen En-Nesaij me'a hashijeti Es-Sujuti. Kajro: Mustafa El-Babi El-Halebij.

Ibn Mendhur, Xhemalud-din Muhamed ibn Mukrem. Pa vit botimi. Lisanu-l-a'reb. Bejrut: Daru Sadir.

Es-Serhasij, Muhamed ibn Ahmed ibn Ebi Sehël. Pa vit botimi. Usulu Es-Serhasij. Rijad: Mektebetu-l-me'arif.